

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

SHERBIME MJETESH
TRANSPORTI

Niveli III
(1 vjeçar)

Kodi: M-III-12

Miratoi:

MINISTRI

MYQEREM TAJAJ

Tiranë, 2012

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve të transportit, si dhe për të vijuar arsimin e lartë dhe formimin profesional të mëtejshëm”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III. kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit II të drejtimin mësimor “Shërbime mjetesesh transporti”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”, niveli III, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit II, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të kryejë llogaritje ekonomike që lidhen me veprimtaritë në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të bëjë organizimin e punës në një servis tipik për shërbimet në mjetet e transportit.
- Të kryejë menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare gjatë veprimtarive në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik dhe financiar që lidhet me veprimtaritë në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të zbatojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të zbatojë standartet teknike që veprojnë në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të zbatojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale në shërbimet e mjeteve të transportit.
- Të kryejë diagnostikimin e parregullsive në mekanizmat dhe sistemet e mjeteve të transportit.
- Të kryejë mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve moderne të mjeteve të transportit.
- Të përzgjedhë, porositë dhe shesë pjesët e këmbimit për mjetet e transportit.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit për shërbimet në mjetet e transportit.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës.
- Të kryejë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarit në punë.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut të shërbimeve të mjeteve të transportit. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në serviset ose kompanitë që ofrojnë shërbimet për mjetet e transportit, në kompanitë që bëjnë tregtimin e mjeteve të transportit ose të pjesëve të këmbimit për mjetet e transportit, si dhe në veprimtari të tjera në kuadrin e shërbimeve të mjeteve të transportit. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit të mëtjshëm në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niv. III.

Plani mësimor për drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/17 (510/578)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2
2		Gjuhë e huaj	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)
4		Histori	2
5		Gjeografi	2
6		Matematikë	2
7		Biologji	2
8		Teknologji informimi e komunikimi	1
9		Lëndë me zgjedhje të detyruar (Fizikë; Kimi; Biologji; Histori arti)	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (306)
1	L-17-197-11	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-18-298-12	Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti	1
4	L-26-299-12	Përdorimi i programit <i>AutoCAD</i> në shërbime mjetesh transporti.	1
5	L-18-300-12	Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit	2
6	L-18-301-12	Sistemet moderne në mjetet e transportit	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (204)
1	M-18-867-12	Punime diagnostikuese në mjetet e transportit	102
2	M-18-868-12	Shërbime në sistemet moderne të mjeteve të transportit	69

3	M-18-869-12	Përzgjedhja, porositja dhe shitja e pjesëve të këmbimit për mjetet e transportit	33
		Gjithsej A+B+C	30/32 (1020/ 1088)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është **motivimi i nxënësve**. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është **integrimi i teorisë me praktikën** e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Rekomandohet përdorimi i metodave të “*simulimit*” dhe të “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Shërbime mjetesh transporti”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimit mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar, sipas Udhëzimeve të MASH.

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e teknikut për shërbime mjetesh transporti, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-11). Kl. 13 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit
- të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit.
- të përshkruajnë aktivitetet e biznesit të kryera nga sipërmarrësit në menaxhimin e biznesit
- të fitojnë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore.
- të dallojnë tiparet dhe aftësitë menaxheriale që lidhen me punën e suksesshme sipërmarrëse.
- të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit.
- të shpjegojnë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit).
- të menaxhojnë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës
- të dallojnë konceptet, sistemet, dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.
- të shpjegojnë nevojën e vlerësimit të tregut dhe dobinë e marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij.
- të shpjegojnë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- të hartojnë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës.
- të përshkruajnë procesin e financimit nëpërmjet krijimit të planit të biznesit dhe analizën e burimeve të financimit.
- të vlerësojnë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.
- të dallojnë kuadrin ligjor dhe detyrimet përkatëse si pjesë aktive e vendimarrjes në një biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 68 orë

Tema 1	Sipërmarrja dhe menaxhimi	4 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe biznesi	5 orë
Tema 3	Aftësitë menaxheriale	8 orë
Tema 4	Funksionet dhe teknikat e menaxhimit	5 orë
Tema 5	Menaxhimi i burimeve njerëzore	7 orë
Tema 6	Menaxhimi i informacionit	6 orë
Tema 7	Menaxhimi marketing	5 orë
Tema 8	Menaxhimi financiar	9 orë
Tema 9	Zhvillimi i një plani biznesi	7 orë
Tema 10	Objektivat e biznesit dhe treguesit e menaxhimit	7 orë
Tema 11	Kuadri ligjor dhe taksat	5 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl.13 – 34 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- të tregojë dhe japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor
- të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 34 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis.	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	4 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal.	3 orë
Tema 10	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti” (L-18-298-12). Kl. 13 – 34 orë

• Synimet e lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti”, kl.13, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë organigramën e një servisi (ndërmarrjeje) për shërbimet e mjeteve të transportit;
- të tregojnë se çfarë pajisjesh përmban një servis tipik për shërbime mjetesh transporti;
- të përshkruajë drejtimit e karrierës dhe përshkrimet e punës në shërbimet e mjeteve të

- transportit;
- të tregojnë si bëhet organizimi i punës në një autoservis;
 - të analizojnë aspektet ligjore të bizneseve në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;
 - të përshkruajnë standardet ndërkombëtare që veprojnë në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;
 - të argumentojnë rëndësinë e etikës së komunikimit me profesionalizëm;
 - të përshkruajnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Organizimi dhe ligjshmëria në shërbime mjetesh transporti”, kl.13 - 34 orë**

Tema 1	Strukturat organizative (organigrama) e një servisi (ndërmarrjeje) për shërbimet e mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 2	Ndërtimi dhe pajisjet kryesore të një servisi tipik për shërbime mjetesh transporti.	2 orë
Tema 3	Karrierat e punësimeve në shërbimet e mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 4	Përshkrimet e punës të personelit në një autoservis tipik.	4 orë
Tema 5	Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në një autoservis.	4 orë
Tema 6	Llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e shërbimit të mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 7	Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 8	Kuadri ligjor dhe normativ që vepron në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 9	Standardet ndërkombëtare që veprojnë në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit.	4 orë
Tema 10	Rregulla të etikës profesionale dhe të komunikimit në një servis për shërbimet në mjetet e transportit	2 orë
Tema 11	Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit.	2 orë
Tema 12	Vizitë në servis për njohjen me organizimin e punës në shërbimet e mjeteve të transportit	6 orë

4. Lënda “Përdorimi i programit *AutoCAD* në shërbime mjetesh transporti” (L-26-299-12). Kl. 13 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Përdorimi i programit *AutoCAD* në shërbime mjetesh transporti”, kl.13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përdorimi i programit *AutoCAD* në shërbime mjetesh transporti”, klasa 13, nxënësi duhet:

- të shpjegoje qëllimin dhe rëndësinë e programit “*AutoCAD*” për shërbimet e mjeteve të transportit.
- të beje figura të thjeshta gjeometrike.
- të beje rakordime të figurave të thjeshta gjeometrike.
- të beje vizatimin e detaleve të thjeshtë të automjeteve.

- të beje prerje të thjeshta të detaleve të automjeteve.
- të beje vizatimin e nyjeve të thjeshta të automjeteve.
- të beje vizatime ne aksonometri të detaleve të thjeshtë të automjeteve.
- të realizoje nxjerrjen e vizatimeve (printimin) me ane të ploterit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Përdorimi i programit *AutoCAD* në shërbime mjeteve transporti”, kl. 13 – 34 orë**

Tema 1	Hyrje, rendesia dhe perparësitë e programit <i>AutoCAD</i> , përdorimet e tij në shërbimet e mjeteve të transportit.	1 ore
Tema 2	Nderfaqja e përdoruesit (nderfaqja grafike, tastat funksionale, hapja e një vizatimi, ruajtja e vizatimit, percaktimi i kufijve të fletës elektronike, percaktimi rrjetës orientuese “ <i>Grid</i> ”, sistemi i njësive me ane të komandës “ <i>Units</i> ”, kontrolli i afëshmimit të vizatimit, rindertimi dhe rivizatimi). Praktikë për hapjen e faqes.	5 ore
Tema 3	Njohja me primitivat grafike në <i>AutoCAD</i> (vija, sistemi koordinativ dhe sintaksa që përdoret në të, ndertimi duke përdorur <i>polar tracking</i>). Praktikë për primitivat grafike.	2 ore
Tema 4	Njohja me primitivat e tjera grafike (<i>arch, circle, line, polygon, rectangle, ellipse, spline</i> etj.). Praktikë për primitivat e tjera grafike.	4 ore
Tema 5	Organizimi i informacionit grafik në shtresë, kursori inteligjent (<i>OSNAP</i>). Praktikë për organizimin grafik në shtresë.	3 ore
Tema 6	Njohja me disa komanda të modifikimit. Praktikë për komandat e modifikimit.	3 ore
Tema 7	Ndertimi i seksioneve tërthore, vendosja e dimensioneve dhe tekstit në një vizatim inxhinierik, matja e parametrave gjeometrik në fletën elektronike. Praktikë për veprimet e mësipërme në detale të mjeteve të transportit.	3 ore
Tema 8	Komanda të tjera modifikimi (<i>ARRAY, MIRROR, EXPLODE, BREAK, ALIGN, MATCH PROPERTIES, PROPERTIES PALETTE</i>). Praktikë për komandat e modifikimit.	3 ore
Tema 9	Ndertimi i blloqeve. Praktikë për ndërtimin e blloqeve	3 ore
Tema 10	Praktikë për vizatimin e detaleve dhe nyjeve të mjeteve të transportit.	5 orë
Tema 11	Nxjerrja e informacionit (printimi) në letër- <i>PLOT</i> . Praktikë për printimin.	2 ore

5. Lënda “Diagnostikimi i parregullsisë në mjetet e transportit” (L-18-300-12). Kl.13 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Diagnostikimi i parregullsisë në mjetet e transportit”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Diagnostikimi i parregullsisë në mjetet e transportit”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për termin “diagnostikim” i parregullsisë.
- Të argumentojnë rëndësinë e diagnostikimit të parregullsisë në automjete.
- Të përshkruajnë parimet në të cilat bazohet diagnostikimi i parregullsisë në automjete.
- Të përshkruajnë metodat dhe mjetet që përdoren në diagnostikimin e parregullsisë në automjete.
- Të përshkruajnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë diagnostikimit të parregullsisë në automjete.
- Të rendisin parregullsitë kryesore në sistemet, mekanizmat dhe agregatet e automjeteve, të tregojnë shkaqet e tyre dhe mënyrat e mënjanimiit.

- Të përshkruajnë procedurat e duhura për diagnostikimin e parregullsive në sistemet, mekanizmat dhe agregatet kryesore të automjeteve.
 - Të përshkruajnë procedurat e diagnostikimit me anën e kompjuteri, të parregullsive në automjetet.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit”, kl.13 - 68 orë**

Tema 1	Parimet, metodat dhe mjetet e diagnostikimit të parregullsive në automjete.	2 orë
Tema 2	Diagnostikimi me kompjuter i parregullsive të automjetit.	10 orë
Tema 3	Diagnostikimi i parregullsive në sistemet elektrike të automjetit	6 orë
Tema 4	Diagnostikimi i parregullsive të mekanizmave dhe sistemeve të motorit	6 orë
Tema 5	Diagnostikimi i parregullsive të elementeve të transmisionit të fuqisë në automjet	10 orë
Tema 6	Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të frenimit të automjetit	10 orë
Tema 7	Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të drejtimit të automjetit	6 orë
Tema 8	Diagnostikimi i parregullsive të sistemeve ndihmëse të automjetit	6 orë
Tema 9	Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të karrocërisë së automjetit	4 orë
Tema 10	Diagnostikimi i parregullsive të sistemit të ecjes së automjetit	8 orë

6. Lënda “Sistemet moderne në mjetet e transportit” (L-18-301-12). Kl.13 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl.13, nxënësit duhet:

- të tregojnë cilat janë sistemet moderne kryesore në mjetet e transportit;
- të përshkruajnë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve moderne për sigurinë e lëvizjes, sigurinë fizike dhe orientimin e mjeteve të transportit;
- të përshkruajnë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve moderne për përmirësimin e parametrave teknike dhe të komfortit në mjetet e transportit;
- të përshkruajnë parimin e punës, ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve moderne për mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të mjeteve të transportit;
- të përshkruajnë prirjet e zhvillimit të mjeteve të transportit të së ardhmes.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl.13 - 68 orë**

Tema 1	Klasifikimi i sistemeve moderne në mjetet e transportit	2 orë
Tema 2	Sistemet moderne të sigurisë së lëvizjes në mjetet e transportit	10 orë
Tema 3	Sistemet moderne të sigurisë fizike (kundra vjedhjes) të mjeteve të transportit	8 orë
Tema 4	Sistemet moderne të orientimit (navigimit) të mjeteve të transportit.	8 orë
Tema 5	Sistemet moderne për përmirësimin e parametrave teknike të mjeteve të transportit	10 orë

Tema 6	Sistemet moderne të komfortit në mjetet e transportit	8 orë
Tema 7	Sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të mjeteve të transportit	8 orë
Tema 8	<u>Veprimtari praktike</u> për njohjen e sistemeve moderne në mjetet e sotme të transportit.	6 orë
Tema 9	Mjetet e transportit të së ardhmes	4 orë
Tema 10	<u>Veprimtari praktike</u> për njohjen e mjeteve të transportit të së ardhmes.	4 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Punime diagnostikuese në mjetet e transportit”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti
Niveli: III
Klasa: 13

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	PUNIME DIAGNOSTIKUESE NË MJETET E TRANSPORTIT	(M-18-867-12)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime të diagnostikimit në sistemet dhe mekanizmat e mjeteve të ndryshme të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit II të drejtimin mësimor “Shërbime mjeteve transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen punime të diagnostikimit në sistemin elektrik të automjetit. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Analiza e dokumentacionit teknik të sistemit të automjetit dhe të sistemit elektrik të tij.– Përgatitja e vendit të punës për punime diagnostikuese në sistemin elektrik të automjetit.– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për punime diagnostikuese në sistemin elektrik të automjetit.– Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemin elektrik të automjetit.– Vendosja e automjetit në postin e punës për diagnostikim. - Diagnostikimi i parregullive të baterisë: <ul style="list-style-type: none">– kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të baterisë dhe përcaktimi i parregullive.– kontrolli me instrument matës i gjendjes së poleve të baterisë dhe përcaktimi i parregullive.– kontrolli i nivelit dhe i dendësisë së elektrolitit të baterisë dhe përcaktimi i parregullive.– kontrolli i tensionit në polet e baterisë (pa ngarkesë) dhe përcaktimi i parregullive.– kontrolli për rrjedhje elektrike (shkarkim) të baterisë dhe përcaktimi i parregullive.– kontrolli i kapacitetit të baterisë (me ngarkesë) dhe përcaktimi i parregullive.	

- Diagnostikimi parregullive të sistemit të lëshimit:

- kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të sistemit të lëshimit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i funksionimit të sistemit të lëshimit me anë të dëgjimit të zhurmave dhe vëzhgimit të reagimit të fluksit të ndriçuesve dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i rrymës së startimit të motorinos, me anë të ampermetrit induktiv dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i rënies së tensionit në polet e baterisë, në momentin e startimit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i rezistencës së izolimit të qarkut të motorinos.
- kontrolli i tokëzimit të qarkut elektrik të motorinos dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes elektrike të solenoidit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i funksionimit të çelësit të kuadrit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes mekanike dhe parametrave elektrike të pjesëve të motorinos së zmontuar, si dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes dhe funksionimit të pinjonit të motorinos së zmontuar dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes dhe funksionimit të solenoidit të zmontuar dhe përcaktimi i parregullive.

- Diagnostikimi parregullive të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike të automjetit:

- kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike, si dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli në ngarkesë i tensionit dhe i rrymës në dalje të alternatorit (gjeneratorit) dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i tensionit në dalje të rregullatorit në ngarkesë minimale dhe maksimale, si dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli me oshiloskop i shkallës së radrizimit të tensionit në dalje të alternatorit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i rezistencës së izolimit dhe i rezistencës së tokëzimit të sistemit të furnizimit me rrymë elektrike dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes së funksionimit të alternatorit, rregullatorit dhe qarkut të furnizimit, me anë të lidhjes “by pass” (lidhjes së shkurtër), si dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli i gjendjes mekanike dhe parametrave elektrike të pjesëve të alternatorit dhe rregullatorit të zmontuara, si dhe përcaktimi i parregullive.

- Diagnostikimi parregullive të sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse të automjetit:

-
- kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të çelësit të kuadrit për komandimin e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli në ngarkesë për përcaktimin e kandeles së parregullt.
 - kontrolli i hapësirës së çelësit të elektrodës së kandeles dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i rezistencës elektrike të fijeve të kandelevë dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i rezistencës së izolimit të fijeve të kandelevë dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i parregullsisë në distributor dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i rezistencave të përshtjellave primare dhe sekondare të bobinës induktive.
 - kontrolli i tensionit në hyrje të bobinës induktive dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i kohës së ngarkimit të bobinës induktive (*dwell*) me pajisjen përkatëse dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i intensitetit të shkëndijës elektrike në kandelat me anë të testuesit të shkëndijës dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i avancës së dhënies së shkëndijës dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Diagnostikimi parregullsisë të sistemit të ndriçimit dhe të sinjalizimit të automjetit:**
- kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes dhe i funksionimit të elementeve të sistemit të ndriçim-sinjalizimit dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të sinjaleve të kthimit, të rrezikut, të frenimit dhe të lëvizjes mbrapa, si dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të ndriçuesve dhe aparaturave të kabinës, si dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të çelësit të komandimit të ndriçuesve dhe sinjalizuesve dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të bories dhe butonit të komandimit, si dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të sistemit të alarmit (sigurisë) dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i funksionimit të ndriçuesve kryesorë dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Përdorimi i kompjuterit për diagnostikimin e parregullsisë në sistemin elektrik të automjetit.

-
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit.
 - Llogaritjet ekonomike për diagnostimin e parregullsive të sistemit elektrik të automjetit.
 - Kujdesi për mjetet e punës.
 - Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit elektrik të automjetit.
 - Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e baterisë;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të lëshimit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të furnizimit me rrymë elektrike të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ndezjes së përzjerjes djegëse;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ndriçimit dhe të sinjalizimit të automjetit.
- të përdorë kompjuterin për diagnostikimin e parregullsive në sistemin elektrik të automjetit;
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për diagnostikimin e sistemit elektrik të automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të sistemit elektrik të automjetit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

RM 2 Nxënësi kryen punime të diagnostikimit në motorin e automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të motorit të automjetit.
- Përgatitja e vendit të punës për punime diagnostikuese në motorin e automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për punime diagnostikuese në motorin e automjetit.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në motorin e automjetit.
- Vendosja e automjetit në postin e punës për diagnostikim

të motorit.

- Diagnostikimi parregullive të trupit të motorit:

- kontrolli pamor i gjendjes së jashtme të trupit të motorit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli me instrumenta i testatës dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli i setit të guarnicioneve dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta matës i qafave të bangos së boshtit motorrik dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta matës i ovalitetit dhe konicitetit të bllokut të cilindrave dhe përcaktimi i parregullive.

- Diagnostikimi parregullive të mekanizmit bjellë- manivelë:

- kontrolli pamor i elementeve të mekanizmit dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta i elementëve të mekanizmit dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta i pistonave e fashove dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrument i bronxinave dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me komparator i syrit të spinotit dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta në bangoprove i bjellave dhe përcaktimi i parregullive.

- Diagnostikimi parregullive të mekanizmit gazshpërndarës:

- kontrolli pamor i elementëve të mekanizmit gazshpërndarjes dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli me instrumenta matës i elementeve të mekanizmit gazshpërndarjes dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli i valvolave me instrumenta dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli i guidave udhëzuese të sedjet e valvolave me instrumenta dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli i boshtit me gunga me instrumenta dhe përcaktimi i parregullive
- kontrolli i punterive hidraulike ose bilancierëve me instrumenta dhe përcaktimi i parregullive.

- Diagnostikimi parregullive të sistemit të vajisjes:

- kontrolli pamor i elementëve të sistemit të vajisjes dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli me pamor i rrjedhjes së vajit dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli pamor i pompës së vajit, permistopëve dhe guarnicionit, si dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli me instrumenta matës i elementëve të sistemit vajisjes dhe përcaktimi i parregullive.
- kontrolli me instrument i valvolës së presionit dhe

- përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli me instrument i valvolës së sigurisë dhe përcaktimi i parregullsive.
- **Diagnostikimi parregullsive të sistemit të ftohjes me ujë:**
 - kontrolli pamor i elementëve të sistemit të ftohjes me ujë dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli me sy i fishave elektrike të impiantit elektrik të termoçiftit dhe përcaktimi parregullsive
 - kontrolli me sy i rrjedhjeve në elementët e sistemit të ftohjes me ujë dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli me instrumente matës i presionit të pompës me ngarkesë dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli me avometër i termoçiftit dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli mekanik me ujë të ngrohtë i termostatit dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i motorit elektrik të sistemit të ftohjes me ujë dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli me dorë i xhokove të boshtit të pompës së ujit dhe përcaktimi i parregullsive
- **Diagnostikimi parregullsive të sistemit të ushqimit të motorit me karburator:**
 - kontrolli pamor i elementëve të sistemit ushqimit të motorit me karburator dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrumente matës i elementëve të sistemit të ushqimit të motorit me karburator dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i karburatorit me instrumenta dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i minimos me kompjuter dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument i presionit të pompës së benzinës dhe përcaktimi i parregullsive
- **Diagnostikimi parregullsive të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”:**
 - kontrolli pamor i elementëve të sistemit të ushqimit të motorit “diesel” dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli mekanik i elementëve të sistemit të ushqimit të motorit “diesel”.
 - kontrolli në bangoprovë i pompës së naftës dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me sy i rrjedhjeve në tubacione apo në elemente të tjerë të sistemit dhe përcaktimi i rrjedhjeve.
 - kontrolli me instrumenta në pompetat me injeksion elektrik
 - kontrolli me instrument i presionit të pompës ushqyese.
 - kontrolli i injektorëve në bangoprovë
 - kontrolli i pastrimit të filtrave të lendës djegëse.
- **Diagnostikimi parregullsive të sistemit të ushqimit të motorit**

me injeksion benzine:

- kontrolli pamor i rrjedhjeve në tubin e injeksionit.
- kontrolli mekanik i bullonave e vidave fiksuese të pompës së injeksionit dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli me anën e provës me çelës kuadri.
- kontrolli me dorë i fishave elektrike nga paketa elektronike deri tek injektorët dhe përcaktimi parregullsive.
- kontrolli me testues kompjuterik i elementeve të sistemit të ushqimit me injeksion benzine dhe përcaktimi parregullsive.
- matja me instrument matës i elementeve elektrike të sistemit të ushqimit me injeksion benzine.

- Diagnostikimi parregullsive të sistemit të thithjes së ajrit dhe shkarkimit të produkteve të djegies:

- kontrolli me sy i gjendjes së jashtme të elementeve të sistemeve të thithjes dhe shkarkimit.
- kontrolli mekanik i kolektorëve të thithjes e shkarkimit dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli me sy i gjendjes së guarnicioneve në kolektorin e shkarkimit dhe në shuaresin e zhurmave, si dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli me anë të dëgjimit në shuaresin e zhurmave dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli me sy i filtrave të ajrit në deburator dhe përcaktimi parregullsive
- Përdorimi i kompjuterit për diagnostikimin e parregullsive në motor.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e parregullsive në motor.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostimin e parregullsive në motor.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të parregullsive në motor.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për diagnostikimin e motorit të automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për diagnostikimin e motorit të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e trupit të motorit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e mekanizmit bjellë-manivelë të motorit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë

- parregullsitë e mekanizmit gazshpërndarës të motorit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të vajisjes së motorit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ftohjes me ujë të motorit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ushqimit të motorit me karburator;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ushqimit të motorit “diesel”;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të ushqimit të motorit me injeksion benzine;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e sistemit të thithjes së ajrit dhe shkarkimit të produkteve të djegies së motorit;
- të përdorë kompjuterin për diagnostikimin e parregullsive në motorin e automjetit;
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për diagnostikimin e motorit të automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të motorit të automjetit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale

RM 3 Nxënësi kryen punime të diagnostikimit në transmisionin e fuqisë së automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit.
 - Përgatitja e vendit të punës për punime diagnostikuese në transmisionin e fuqisë së automjetit.
 - Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për punime diagnostikuese në transmisionin fuqisë së automjetit.
 - Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në transmisionin e fuqisë së automjetit.
 - Vendosja e automjetit në postin e punës për diagnostikim të elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit.
- Diagnostikimi parregullsive të friksionit:**
- kontrolli pamor i gjendjes së jashtme teknike të friksionit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i hapësirave dhe i konsumit të ferrotave dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i rrugës së lirë të pedalit të friksionit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i kushinetës së freksionit dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i disqeve metalike dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i pompës dhe turbinës në freksionin hidraulik dhe

- përcaktimi i parregullsisë
- kontrolli për rrjedhje vaji në freksionin hidraulik dhe përcaktimi i parregullsisë
- kontrolli i mekanizmit mekanik të komandimit të freksionit dhe përcaktimi i parregullsisë
- kontrolli i mekanizmit hidraulik të komandimit të freksionit dhe përcaktimi i parregullsisë.
- **Diagnostikimi parregullsisë të kutisë së ndërrimit të shpejtësisë (KNSH):**
 - kontrolli pamor i gjendjes së jashtme teknike të KNSH dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli me instrumenta matës i gjendjes teknike të KNSH dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - prova me ngarkesë të KNSH për rrjedhje vaji dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i lidhjeve të KNSH me elementet e tjera dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i rrotave të dhëmbëzuara të KNSH dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i elementeve të mekanizmit të komandimit të KNSH dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i kushinetave dhe boshteve të KNSH dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - Kontrolli i nivelit të vajit të KNSH.
- **Diagnostikimi parregullsisë të transmisionit kardanak:**
 - kontrolli pamor i gjendjes së jashtme teknike të elementeve të transmisionit kardanak dhe përcaktimi i parregullsisë
 - kontrolli me instrumenta matës i gjendjes teknike të elementeve të transmisionit kardanak dhe përcaktimi i parregullsisë
 - kontrolli i ballancimit të boshtit kardanak dhe përcaktimi i parregullsisë
 - kontrollimi i gjendjes teknike të bashkueseve (xhuntove) dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrollimi i gjendjes teknike të kushinetës ndërmjetëse dhe përcaktimi i parregullsisë
 - kontrollimi i hapësirave të shlizave dhe përcaktimi i parregullsisë
- **Diagnostikimi parregullsisë të transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve:**
 - kontrolli pamor dhe dëgjimor i gjendjes së jashtme teknike të transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli me instrumenta matës i gjendjes teknike të transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve dhe përcaktimi i parregullsisë.
 - kontrolli i nivelit të vajit në transmisionin kryesor.
 - kontrollimi i dëmtimeve në permistopa dhe garnicione.
 - kontrolli i kushinetave të transmisionit kryesor,

- diferencialit dhe gjysëmboshteve dhe përcaktimi i parregullsisë.
- kontrolli i çiftit pinjon-koronë të transmisionit kryesor dhe përcaktimi i parregullsisë.
- kontrolli i rrotave me dhëmbë të diferencialit dhe përcaktimi i parregullsisë
- kontrolli i gjysëmboshteve dhe përcaktimi i parregullsisë.
- Përdorimi i kompjuterit për diagnostikimin e parregullsisë në transmisionin e fuqisë së motorit.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e parregullsisë në transmisionin e fuqisë së motorit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostikimin e parregullsisë në transmisionin e fuqisë së motorit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të parregullsisë në transmisionin e fuqisë së motorit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për diagnostikimin e elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për diagnostikimin e elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e friksionit të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e kutisë së ndërrimit të shpejtësisë;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e transmisionit kardanic të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e transmisionit kryesor, diferencialit dhe gjysëmboshteve të automjetit;
- të përdorë kompjuterin për diagnostikimin e parregullsisë në elementet e transmisionit të fuqisë së automjetit;
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për diagnostikimin e elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të elementeve të transmisionit të fuqisë së automjetit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

RM 4 Nxënësi kryen punime të diagnostikimit në sistemet e drejtimit dhe të frenimit të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të elementeve të sistemit të drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Përgatitja e vendit të punës për punime diagnostikuese në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për punime diagnostikuese në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Vendosja e automjetit në postin e punës për diagnostikim të elementeve të sistemit të drejtimit ose frenimit të automjetit.
- ***Diagnostikimi parregullsive të sistemit të drejtimit:***
 - kontrolli pamor i elementeve të sistemit të drejtimit, përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i korsës (në gradë) të volantit të timonit, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i kryqeve të mekanizmit të komandimit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i krahëve të paralelit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i kokave të paralelit dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli teknik i gominave fizarmonikë të krahëve të paralelit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i gominave të suporteve të grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i kushinetave të kremalierës së grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i dhëmbëve të kremalierës dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument matës i aksit të grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument matës i bokullave të aksit në grupin e timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument matës i bokullës regjistruese prej tefloni dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i sustës regjistruese dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i pikave të grasatimit dhe përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i nivelit të vajit të grupit të timonit hidraulik dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i regjistrimit të rripit të pompës hidraulike, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i tubave të presionit të lartë i grupit të timonit, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i serpentines ftohëse të vajit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - matja e presionit të vajit të pompës hidraulike dhe

- përcaktimi i parregullsive.
- testimi me pajisje i pompës hidro-elektrike të grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli i shpërndarësit të vajit të grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli i permistopave të grupit të timonit dhe përcaktimi i parregullsive.
- kontrolli i gominave të suporteve të grupit të timonit hidraulik dhe përcaktimi i parregullsive.
- matja e presionit hidraulik të grupit të timonit duke testuar temperaturën e tij dhe përcaktimi i parregullsive.
- **Diagnostikimi parregullsive të sistemit të frenimit:**
 - kontrolli pamor i elementeve të sistemit të frenimit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me pajisje matëse i funksionit të depresorit dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me pajisje testuese i përqëndrimit të alkoolit në depozitë dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i pompës së frenave me pajisje matëse për presionin e duhur dhe përcaktimi i parregullsive.
 - testimi me aparat testues i pompës dhe fijeve sinjalizuese të bllokut të *abs*, *srs*, *esp* dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument matës në bokullat e urës udhëzuese dhe në të pistonçinat e frenave me disk, përcaktimi i parregullsive.
 - matja e trashësisë së ferrodave të frenave me disk, përcaktimi i parregullsive.
 - matja e trashësisë së disqeve të frenimit, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me indikator për qendërzimin e disqeve të frenimit, përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli me indikator i qendërzimit të tamburit të frenave, përcaktimi i parregullsive.
 - matja e trashësisë së tamburit, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli me instrument matës i ferrodave të çepave të frenave, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i pistonçinave të çepave të frenave, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i funksionimit të regjistruetit mekanik të çepave të frenave, përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i elementëve të rikthimit të çepave të frenave, përcaktimi i parregullsive
 - kontrolli i mekanizmit të levës së frenave të dorës dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli teknik i udhëzuesve dhe kavove të frenave të dorës dhe përcaktimi i parregullsive.
 - kontrolli i mekanizmit regjistruetit të kavove të frenave të dorës dhe përcaktimi i parregullsive.
- Përdorimi i kompjuterit për diagnostikimin e parregullsive në

- sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për diagnostikimin e parregullsive në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për diagnostimin e parregullsive në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të parregullsive në sistemin e drejtimit ose frenimit të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për diagnostikimin e elementeve të sistemeve të drejtimit dhe të frenimit të automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për diagnostikimin e elementeve të sistemeve të drejtimit dhe të frenimit të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e elementeve të sistemit të drejtimit të automjetit;
- të kryejë kontrollet dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë e elementeve të sistemit të frenimit të automjetit;
- të përdorë kompjuterin për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit të automjetit;
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për diagnostikimin e elementeve të sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit të automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë diagnostikimit të elementeve të sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit të automjetit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime të mjeteve të transportit ose në servise private të automjeteve ku kryhen diagnostikime.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave, teknikave dhe procedurave për diagnostikimin e parregullsive në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e procedurave të diagnostimit të parregullsive në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsive në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve.

-
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e diagnostikimit të parregullsisve në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbimet e diagnostikimit të parregullsisve në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve.
 - Automjet në gjendje pune.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje dhe kontrole në sistemet dhe mekanizmat e automjeteve.
 - Kompjuter për diagnostikim automjetesh.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet e automjeteve.
 - Katalogë të automjeteve, manuale, udhëzuesa pune, rregullore, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Shërbime në sistemet moderne të mjeteve të transportit”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti

Niveli: III

Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	SHERBIME NE SISTEMET MODERNE TË MJETEVE TE TRANSPORTIT	(M-18-868-12)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer shërbime të riparimit dhe zëvendësime të pjesëve në sistemet moderne të mjeteve të ndryshme të transportit.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit II të drejtimin mësimor “Shërbime mjeteve transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen shërbime të riparimit në sistemet moderne të sigurisë së automjeteve. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Analiza e dokumentacionit teknik të sistemeve moderne të sigurisë së automjetit.– Përgatitja e vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.– Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.– Vendosja e automjetit në postin e punës për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.– Përcaktimi i parregullsive (edhe me anë të kompjuterit) në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.– Procedura e riparimit të ABS (<i>anti brake system</i>).– Procedura e riparimit të sistemit të aktivizimit rripit të sigurisë dhe të <i>airbag</i>-ut (<i>SRS-Supplemental Restraint System</i>).– Procedura e riparimit të sistemit për kontrollin e presionit të gomave;– Procedura e riparimit të sistemit për kontrollin e kapjes së rrotave me sipërfaqen e rrugës (<i>TCS-traction control system</i>).– Procedura e riparimit të sistemeve elektronike për parkimin, ruajtjen e distancës me mjetet e tjera, pengimin e mënjanimin të mjetit etj.	

-
- Procedura e riparimit të sistemeve të alarmit dhe kundra vjedhjes së automjetit.
 - Procedura e riparimit të sistemit të komandimit të hapjes dhe mbylljes së dyerve të mjetit.
 - Plotësimi i dokumentacionit teknik për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.
 - Llogaritjet ekonomike për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.
 - Kujdesi për mjetet e punës.
 - Rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.
 - Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit;
- të kryejë kontrollet (edhe me kompjuter) dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë në sistemet moderne të sigurisë së automjetit;
- të kryejë riparimin e ABS (*anti brake system*).
- të kryejë riparimin e sistemit të aktivizimit rripit të sigurisë dhe të *airbag*-ut (*SRS-Supplemental Restraint System*).
- të kryejë riparimin e sistemit për kontrollin e presionit të gomave;
- të kryejë riparimin e sistemit për kontrollin e kapjes së rrotave me sipërfaqen e rrugës (*TCS-traction control system*).
- të kryejë riparimin e sistemeve elektronike për parkimin, ruajtjen e distancës me mjetet e tjera, pengimin e mënjanimit të mjetit etj.
- të kryejë riparimin e sistemeve të alarmit dhe kundra vjedhjes së automjetit.
- të kryejë riparimin e sistemit të komandimit të hapjes dhe mbylljes së dyerve të mjetit.
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në sistemet moderne të sigurisë së automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të sigurisë së automjetit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

RM 2 Nxënësi kryen shërbime të zëvendësimit në sistemet moderne të orientimit (navigimit) të automjetit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemeve moderne të orientimit të automjetit.
- Përgatitja e vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Vendosja e automjetit në postin e punës për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Përcaktimi i parregullsive (edhe me anë të kompjuterit) në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Procedura e zëvendësimit të *GPS (Global Positioning System)* të inkuorporuar në automjet.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit;
- të kryejë kontrollet (edhe me kompjuter) dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë në sistemet moderne të orientimit të automjetit;
- të kryejë zëvendësimin e *GPS (Global Positioning System)* të inkuorporuar në automjet.
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në sistemet moderne të orientimit të automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të orientimit të automjetit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

RM 3 Nxënësi kryen shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemet moderne të komfortit të automjetit.

Përmbajtja:



- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemeve moderne të komfortit të automjetit.
- Përgatitja e vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Vendosja e automjetit në postin e punës për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Përcaktimi i parregullsive (edhe me anë të kompjuterit) në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Procedura e riparimit të sistemit të klimatizimit të kabinës (A/C).
- Procedura e riparimit të pajisjeve të zërit (audio) në kabinë.
- Procedura e riparimit të mekanizmave të komandimit të ndenjësive në kabinë.
- Procedura e riparimit të mekanizmave të komandimit të xhamave të dyerve.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Llogaritjet ekonomike për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të komfortit të automjetit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit;
- të kryejë kontrollet (edhe me kompjuter) dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë në sistemet moderne të komfortit të automjetit;
- të bëjë riparimin e sistemit të klimatizimit të kabinës (A/C).
- të bëjë riparimin e pajisjeve të zërit (audio) në kabinë.
- të bëjë riparimin e mekanizmave të komandimit të ndenjësive në kabinë.
- të bëjë riparimin e mekanizmave të komandimit të xhamave të dyerve.
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në sistemet moderne të komfortit të automjetit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të komfortit të automjetit.



- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

RM 4 Nxënësi kryen shërbime të zëvendësimit dhe riparimit në sistemet moderne të automjetit për mbrojtjen e mjedisit.

Përmbajtja:

- Analiza e dokumentacionit teknik të sistemeve moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Përgatitja e vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për shërbimet në sistemet moderne të automjetit për mbrojtjen e mjedisit.
- Marrja e informacionit paraprak për parregullsitë në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit
- Vendosja e automjetit në postin e punës për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Përcaktimi i parregullsive (edhe me anë të kompjuterit) në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Procedura e zëvendësimit të katalizatorit të gazrave që shkarkohen.
- Procedura e zëvendësimit të valvolës *PCV (positive crankcase ventilation)*.
- Procedura e zëvendësimit të valvolës *EGR (exhaust gas recirculation)*.
- Plotësimi i dokumentacionit teknik për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Llogaritjet ekonomike për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të automjetit për mbrojtjen e mjedisit.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë analizat paraprake për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit;
- të bëjë parapërgatitjen e automjetit dhe të vendit të punës për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit;
- të kryejë kontrollin (edhe me kompjuter) dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë në sistemet moderne të automjetit për mbrojtjen e mjedisit;
- të bëjë zëvendësimin e katalizatorit të gazrave që shkarkohen
- të bëjë zëvendësimin e valvolës *PCV (positive crankcase ventilation)*.
- të bëjë zëvendësimin e valvolës *EGR (exhaust gas recirculation)*.
- të plotësojë siç duhet dokumentacionin teknik dhe financiar

- për shërbimet në sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë shërbimeve në sistemet moderne të automatizimit për mbrojtjen e mjedisit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime të mjeteve të transportit ose në servise private të automjeteve ku kryhen shërbime të sistemeve moderne të automjeteve.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të metodave, teknikave dhe procedurave për diagnostikimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve moderne të automjeteve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e procedurave të diagnostikimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve moderne të automjeteve, fillimisht në mënyrë të mbikqyruar nga instruktori dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë praktike që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e simulimit të parregullsisve në sistemet moderne të automjeteve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për kryerjen e shërbimeve në sistemet moderne të automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart pune për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve moderne të automjeteve.
 - Automjet në gjendje pune.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve moderne të automjeteve.
 - Pjesë këmbimi për sistemet moderne të automjeteve.
 - Kompjuter për diagnostikim automatizuesh.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar për shërbimet e automjeteve.
 - Katalogë të automjeteve, manuale, udhëzuesa pune, rregullore, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Përzgjedhja, porositja dhe shitja e pjesëve të këmbimit për mjetet e transportit”

Drejtimi: Shërbime mjeteve transporti
Niveli: III
Klasa: 13

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	PERZGJEDHJA, POROSITJA DHE SHITJA E PJESEVE TE KEMBIMIT PER MJETET E TRANSPORTIT	(M-18-869-12)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të bërë përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për mjetet e transportit, duke përdorur katalogët ose programet kompjuterike përkatëse.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga profilet mësimore të nivelit II të drejtimin mësimor “Shërbime mjeteve transporti”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përzgjedh, porosit ose shet pjesë këmbimi për automjetet duke përdorur katalogë. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Marrja e informacionit paraprak për pjesët e këmbimit të automjetit.– Analiza e dokumentacionit teknik dhe përcaktimi i të dhënave (marka, lloji, viti i prodhimit, numri i shasisë) të automjetit.– Përcaktimi dhe saktësimi i pjesëve të këmbimit që do të porositen ose shiten.– Përzgjedhja e katalogut të pjesëve të këmbimit të automjetit përkatës.– Gjetja e pjesëve të këmbimit në katalog dhe përcaktimi i kodeve të tyre.– Plotësimi i formularit për porositjen e pjesëve të këmbimit të automjetit.– Përcaktimi i vendndodhjes së pjesëve të këmbimit në magazinë.– Plotësimi i faturës së shitjes së pjesëve të këmbimit.– Etika e komunikimit profesional me klientët. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të marrë informacionin paraprak për pjesët e këmbimit të automjetit.	

-
- të analizojë dokumentacionin teknik dhe të përcaktojë saktë të dhënat (marka, lloji, viti i prodhimit, numri i shasisë) e automjetit.
 - të përcaktojë saktë pjesët e këmbimit që do të porositen ose do të shiten.
 - të përzgjedhë katalogun e duhur të pjesëve të këmbimit të automjetit përkatës.
 - të gjejë pjesët e duhura të këmbimit në katalog dhe të përcaktojë saktë kodet e tyre.
 - të plotësojë si duhet formularin për porositjen e pjesëve të këmbimit të automjetit.
 - të përcaktojë vendndodhjen e pjesëve të duhura të këmbimit në magazinë.
 - të plotësojë si duhet faturën e shitjes së pjesëve të këmbimit.
 - të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale me klientët.

RM 2 Nxënësi përzgjedh, porosit ose shet pjesë këmbimi për automjetet duke përdorur programe kompjuterike.

Përmbajtja:

- Marrja e informacionit paraprak për pjesët e këmbimit të automjetit.
- Analiza e dokumentacionit teknik dhe përcaktimi i të dhënave (marka, lloji, viti i prodhimit, numri i shasisë) të automjetit.
- Përcaktimi dhe saktësimi i pjesëve të këmbimit që do të porositen ose shiten.
- Përgatitja e kompjuterit dhe përzgjedhja e programit kompjuterik përkatës.
- Gjetja e pjesëve të këmbimit në programin kompjuterik dhe përcaktimi i kodeve të tyre.
- Plotësimi i formularit për porositjen e pjesëve të këmbimit të automjetit.
- Përcaktimi i vendndodhjes së pjesëve të këmbimit në magazinë.
- Plotësimi i faturës së shitjes së pjesëve të këmbimit.
- Etika e komunikimit profesional me klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacionin paraprak për pjesët e këmbimit të automjetit.
- të analizojë dokumentacionin teknik dhe të përcaktojë saktë të dhënat (marka, lloji, viti i prodhimit, numri i shasisë) e automjetit.
- të përcaktojë saktë pjesët e këmbimit që do të porositen ose do të shiten.

- të përgatitë kompjuterin dhe të përzgjedhë programin kompjuterik përkatës.
- të gjejë pjesët e këmbimit në programin kompjuterik dhe të përcaktojë saktë kodet e tyre.
- të plotësojë si duhet formularin për porositjen e pjesëve të këmbimit të automjetit.
- të përcaktojë vendndodhjen e pjesëve të duhura të këmbimit në magazinë.
- të plotësojë si duhet faturën e shitjes së pjesëve të këmbimit.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale me klientët.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shkollës për shërbime të mjeteve të transportit, në servise private të automjeteve ose në dyqane ku kryhen shitje të pjesëve të këmbimit për automjetet.
- Mësuesi i praktikës duhet të demonstrojë procedurat e përzgjedhjes, porositjes dhe shitjes së pjesëve të këmbimit të automjeteve, duke përdorur katalogët dhe programet kompjuterike përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes, porositjes dhe shitjes së pjesëve të këmbimit të automjeteve, duke përdorur katalogët dhe programet kompjuterike përkatëse, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat që kryejnë.
- Instruktori duhet të përdorë metodën e "lojës me role", ku nxënësit angazhohen në mënyrë të alternuar në rolet e klientit, porositësit apo të shitësit të pjesëve të këmbimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit të automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise pune për përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit të automjeteve.
 - Katalogë të pjesëve të këmbimit të automjeteve.
 - Kompjuter dhe programe kompjuterike për pjesët e këmbimit të automjeteve.
 - Formate të dokumentacionit teknik për porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit të automjeteve.
 - Udhëzuesa pune, rregullore dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

